



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:168533

Datë: 20.10.2022

Numri i dokumentit: 03553687

C.nr.749/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, me zytaren ligjore Albulena Latifi, në çështjen juridike të paditësit F. H. Sh. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson i autorizuari av.R. B. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurve E., N., A. dhe A. D. që të gjithë nga Rahoveci, për vërtetimin e pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datës 05.10.2022 në prezencën e palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datë **20.10.2022** merr këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit F. H. Sh. nga Rahoveci dhe **VËRTETOHET** se i njëjti është pronar i paluajtshmërisë së evidentuar si njësi kadastrale me **Nr.4663-1, ZK Rahovec**, pronë private, vendi i quajtur “Carina”, me kulturë ”Vreshtë e kl.1” me sipërfaqe prej 470m², e cila kufizohet në anën verilindore me parcelën 4663-2 në gjatësi të përgjithshme prej 47.23m, në anën juglindore me parcelën 6249-0 në gjatësi të përgjithshme prej 9.8m, në anën jugperëndimore me parcelën 4664-0 në gjatësi 8.42m+10.97m+24.29m, e në gjatësi të përgjithshme prej 43.68m dhe në anën veriperëndimore me parcelën nr.4680-2 në gjatësi të përgjithshme prej 12.08m, ashtu që **detyrohen** të paditurit E. H. D., N. D., A. S. D. dhe A. S. D. që të gjithë nga Rahoveci, që ta pranojnë këtë dhe që të lejojnë regjistrimin e paluajtshmërisë në emër të paditësit në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Rahovecit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi F. H. Sh. nga Rahoveci, përmes të autorizuarit av. R. B. nga Rahoveci, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurve E., N., A. dhe A. D. që të gjithë nga Rahoveci, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes) në pjesën e paluajtshmërisë nr.4663-0 ZK Rahovec, përkatësisht në parcelën nr.4663-1 me sipërfaqe prej 470m² ZK Rahovec.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ka caktuar shqyrtimin kryesor në të cilin kanë prezentuar palët ndërgjyqëse. Ka caktuar ekspertizën e gjeodezisë dhe së bashku me palët ndërgjyqëse ka dalë në vend. Eksperti i gjeodezisë është obliguar që të kryej matjet dhe të bëjë ndarjen e parcelën nr.4663-0, duke i krijuar dy parcela dhe atë parcelën kontestuese nr.4663-1 me sipërfaqe prej 470m² dhe parcelën nr.4663-2 me sipërfaqe prej 946m² me kufizime me metrazhë dhe skicë.

Gjykata me shikimin në Certifikatën e paluajtshmërisë Nr.08-942/03-0020943/21 të datës 24.05.2021 dhe Ekspertizën e gjeodezisë të datës 31.08.2022 të cilave ua dha besimin e plotë ka vërtetuar faktin se parcela nr.4663-0 me sipërfaqe prej 1428m² evidentohet në emër të të ndjerit H. M. D. nga Rahoveci.

Gjykata me shikimin në Dëshmi-vdekjet (në emër të të ndjerit H. D. dhe S. H. D.) e datës 12.07.2021 ka vërtetuar faktin se i nderi H. M. D., këtu pronari i parcelës ka vdekur me datë 07.10.2016 dhe pas vehtes ka lënë pasardhësit ligjor-trashëgimtarët e mundshëm, këtu të paditurit, duke e vërtetuar në mënyrë të plotë legjitimitetin pasiv të palëve në procedurë.

Të paditurit në përgjigjjen në padi të datës 21.06.2022, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e kanë pohuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Ndër të tjera kanë shtuar se nga administrimi i provave është vërtetuar në mënyrë të plotë kërkesëpadia si e bazuar dhe i kanë propozuar gjykatës që të nxjerrë vendim me të cilin ia njeh të drejtën e pronësisë paditësit në parcelën nr.4663-1 ZK Rahovec.

Andaj, gjykata (duke pasur parasysh faktin se kërkesat e palëve në procedurë nuk bien ndesh me nenin 3 par.3 të LPK-së) me pajtimin e plotë të palëve në procedurë dhe në pajtueshmëri të nenit 148.1, lidhur me nenin 160.6 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit konform nenit 450 të LPK-së sipas deklaratimit të palëve ndërgjyqëse.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
C.nr.749/2021, me datë 20.10.2022.

Zyrtarja ligjore
Albulena Latifi

Gj y q t a r i
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në këtë gjykatë, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë dhe atë vetëm për shkak të shkeljeve të dispozitave të LPK-së, nenit 181.2.